



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1853/1 prot

Datë 11.07.2025

FORMULAR PËR PUBLIKIM
LIDHUR ME ARSYET E SKUALIFIKIMIT NË RASTIN E ANKESAVE PËR
VENDIMIN E VLERËSIMIT/KLASIFIKIMIT PËRFUNDIMTAR

- Objekt:** Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “KAPPA - OIL” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-46807-05-02-2025, me objekt: “Loti 3 – Blerje vajra, lubrifikantë, alkool frenash dhe pastrues motori”, me fond limit 83,967,400.00 lekë, zhvilluar në datë 04-06-2025 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve te Perqendruara.
- Ankimues:** Operatori ekonomik “KAPPA - OIL” SHPK me NIPT (J91402501L), me adresë: *Zona Kadastrale 2547, Nr.Pasurie 159/182, Vol 19, Fq 219.*
- Autoriteti Kontraktor:** Operatori i Blerjeve te Perqendruara, me adresë: Rruga “Reshit Çollaku”, Godina Nr.6/337, Tiranë (në krah të Gjykatës së Lartë)..

Pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankimi elektronik me nr. A/2025/5546, datë 11.07.2025 dhe me nr. protokolli 1853/2025 datë 11.07.2025 e operatorit ekonomik “KAPPA - OIL” SHPK për procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-46807-05-02-2025, me objekt: “Loti 3 – Blerje vajra, lubrifikantë, alkool frenash dhe pastrues motori”, me fond limit 83,967,400.00 lekë, zhvilluar në datë 04-06-2025 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve te Perqendruara.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “KAPPA - OIL” SHPK, në procedurën e mësipërme të prokurimit.

Bazuar në nenin 112, pika 4, gërma “b” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: *“Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, KPP-ja publikon:*

b) arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar;”.

Komisioni i Prokurimit Publik do të publikojë arsyet e skualifikimit që operatori ekonomik “KAPPA - OIL” SHPK kundërshton me anë të ankesës me nr. 1853 protokolli, datë 11.07.2025. Konkretisht për arsyet e skualifikimit si më poshtë:

“- Nuk permbush piken 2.3.4 të Kapacitetit Teknik për arsyen si më poshtë: • Per artikullin Nr 40 “Solucion pastrimi radiator” operatori ekonomik ne permbushje te kriterit 2.3.4 ka paraqitur ne SPE Skede Teknike te markuar artikullin e emertuar “STOP LEAK”. KVO nga verifikimet e pershkrimit ne skeden teknike te paraqitur nga OE, konstaton se ky artikull nuk eshte solucion i cili ka te beje me pastrimin e radiatorit por eshte produkt i cili sherben per mbylljen e carjeve duke ndaluar rrjedhjet ne sistemet e qarkullimit te ujit, pra eshte i ndryshem nga artikulli i kerkuar ne DT.”

Publikuar në regjistrin e ankesave më datë 11.07.2025.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Gjergj Mersini

Nënkryetar
Fiovent Zguro